



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.05.2023

Nr: 117

Ora: 13:30

**VENDIM**

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 62, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 17.05.2023 NGA "PARTIA UNITETI KOMBËTAR"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Partia e Unitetit Kombëtar", përfaqësuar nga z. Idajet Beqiri

**OBJEKT:** Pavlefshmëria e tabelave përmbledhëse për KZAZ nr. 12 dhe nr. 13, Lezhë

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 62 regj., datë 17.05.2023.

Në mbledhjen e datës 18.05.2023, ora 13:30, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht:

**Së pari:** Në ankim nuk është referuar vendimi/vendimet që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor;

**Së dyti:** ankuesi nuk ka depozituar së bashku me ankimin, një përshkrim më të detajuar dhe të saktë të fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore, ku mbështetet ankimi sipas parashikimit të nenit 126, pika 1 shkronja “d” të Kodit Zgjedhor;

**Së treti:** ankimi i paraqitur në KAS nuk është shoqëruar me asnjë provë dhe nuk tregon asnjë provë që kërkohet të merret gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, në funksion të zgjidhjes së çështjes, sic parashikohet në nenin 126, pika 1, shkronja “e” të Kodit Zgjedhor.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjave “b” , “d” dhe “e” të pikës 1, të nenit 126, të K.Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

### **V E N D O S I:**

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 62, datë 17.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.

Data: 18.05.2023 Nr: 117  
Ora: 13:30



“Për kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr. 62, të depozituar në KQZ në datën 17.05.2023 nga ‘Partia e Unitetit Kombëtar’”

2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 19.05.2023, ora 13:40.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraprak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 18.05.2023.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	- <b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	- <b>Anëtar</b>